AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qëndrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K 3/L 22-18 **Prot.** **Tiranë** 18/ 5 **/2026**
Nr. Dok. 202501221/

Lënda: *Rekomandim për ushtrimin e kompetencave ligjore të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Fier, në trajtimin e ankesës së shtetasit Lefter Troka.*

Drejtuar: **Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Fier**

Fier

Për dijeni: **Z. Lefter TROKA**
Lagjia "Apollonia", Rruga "Harilla Bozo"

Fier

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, nga shtetasi Lefter Troka, i cili ka shprehur shqetësimin në lidhje me mosveprimin në kohë të organeve kompetente shtetërore dhe në vazhdim të organit tuaj publik, ndaj një ndërtimi të kundërligjshëm.

Ankuesi shkruan se është pronar i një banese në lagjen "Apollonia", Fier, të cilën e ka përfituar nëpërmjet procesit të privatizimit. Ndërkohë, ai shprehet se shtetasi Dhimitër Konomi, ka nisur ndërtimin e një objekti pa leje që në vitin 1998, shumë pranë pronës së ankuesit, fakt për të cilin është mbajtur edhe një proces-verbal konstatimi (datë 23.08.1998), nga ana e inspektorëve të urbanistikës, në Bashkinë Fier.

Megjithatë, ndaj këtij ndërtimi të paligjshëm nuk është vepruar dhe nuk po veprohet prej kohësh, ndërkohë që ai cenon funksionalitetin e banesës së ankuesit.

Në këto rrethana, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen nga ana e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Pas regjistrimit të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, ankesa e paraqitur plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenin 13, nenin 17, shkronja "a" dhe nenin 18, shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar *(ligji nr. 8454/1999)*, ka vendosur ta pranojë atë dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes[1].

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor dhe konkretisht, të paragrafit 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij",

si dhe nenit 19, shkronja "b", të ligjit nr. 8454/1999, ku parashikohet se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:

b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin",

në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, iu jemi drejtuar me disa shkresa për shpjegime përkatëse për këtë çështje.

Për sqarimin e kësaj çështjeje me shkresën tonë nr. K3/L22-2 prot., datë 17.09.2024, kemi kërkuar nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Fier, dërgimin e shpjegimeve të detajuara lidhur me arsyet e mostrajtimit në kohë dhe sipas afateve ligjore të kësaj çështjeje, si dhe të masave që do të merreshin në vazhdim, për zgjidhjen përfundimtare të saj.

Për shkak të mungesës së përgjigjes iu jemi ridrejtuar në vazhdim me shkresat tona të përsëritura për shpjegime nr. K3/L22-4 prot., datë 28.10.2024, nr. K3/L22-5 prot., datë 27.11.2024, nr. K3/L22-6 prot., datë 28.01.2025, nr. K3/L22-7 prot., datë 27.02.2025 dhe nr. K3/L22-8 prot., datë 01.04.2025.

Me shkresën tuaj nr. 4211/1 prot., datë 09.04.2025, drejtuar Avokatit të Popullit, na është dhënë prej jush informacioni se nuk dispononi praktika administrative, referuar kohës së nxjerrjes së akt konstatimit datë 23.08.1998, të cituar nga ankuesi. Për këtë arsye, ju keni kërkuar vënien në dispozicion të praktikës dhe informacioneve më të detajuara lidhur me këtë ankesë, pasi sipas jush, mosveprimi në kohë kërkon një azhornim të situatës juridike të rastit në fjalë.

---

[1] Neni 13, i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur veren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike"*

Bazuar në këtë kërkesë tuajën, me shkresën tonë nr. K3/L22-10 prot., datë 17.04.2025, iu kemi dërguar një kopje të dokumentacionit zyrtar që, z. Troka, i ka bashkëlidhur ankesës së paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, duke kërkuar në vijim dërgimin e shpjegimeve për trajtimin e kësaj çështjeje.

Sërish nuk ka patur përgjigje nga ana juaj dhe në këto kushte iu jemi ridrejtuar me kërkesa për shpjegime të përsëritura me shkresat tona, nr. K3/L22-11 prot., datë 28.05.2025, nr. K3/L22-12 prot., datë 01.07.2025, nr. K3/L22-13 prot., datë 21.08.2025 dhe nr. K3/L22-14 prot., datë 17.10.2025.

Në përgjigje të këtyre kërkesave për shpjegime, me shkresën tuaj nr. 11861/1 prot., datë 03.11.2025, na jepni informacionin se pas verifikimeve të kryera në terren dhe krahasimit me të dhënat në certifikatën e pronësisë, rezulton se z. Troka, ka në pronësi aq sa është përcaktuar në dokumentin e tij të pronësisë. Kollonat dhe muri që ai pretendon të prishë nuk janë në pronësi të tij, sipas kufijve të pasqyruar në dokumentacionin përkatës. Sipas kësaj përgjigjeje, ankuesi ka certifikatë pronësie me nr. pasurie 2/85, me sipërfaqe totale 99.50 m2, nga e cila 81.50 m2 është ndërtesë. Në përgjigjen tuaj thuhet se, z. Troka pretendon të marrë pasurinë me nr. 2/358, e cila sipas kartelës së saj të pasurisë rezulton pasuri kufizuese në krahun lindor.

Në vijim, në këtë përgjigje thuhet se, ju si organ publik nuk dispononi asnjë dokument që autorizon prishjen e objektit në fjalë. Sipas arkivës, ekziston vetëm procesverbali i vitit 1998, për vendosjen e gjobës administrative prej 5.000 lekë, për kryerje të ndërtimit pa leje. Në përfundim, ju shkruani se nuk është kompetencë e IMT-së në Bashkinë Fier, ndarja e pronësisë, apo caktimi i kufijve të pronës.

Referuar kësaj përgjigjeje me shkresën tonë nr. K3/L22-16 prot., datë 20.11.2025, kemi sjellë në vëmendjen tuaj faktin se, objekti i ankesës së z. Troka, ka të bëjë me ndërtimin e një objekti pa leje që në vitin 1998, nga shtetasi Dhimitër Konomi, shumë pranë pronës së ankuesit, fakt për të cilin është mbajtur edhe një proces-verbal konstatimi (datë 23.08.1998), nga ana e inspektorëve të urbanistikës, në Bashkinë Fier. Në këtë shkresë tonën është theksuar se, për sa janë dhënë sqarime nga ana juaj nuk qartësojnë faktin nëse kemi të bëjmë me një ndërtim pa leje në këtë rast, apo jo. Nga ana tjetër, kemi nënvizuar se në shkresat tona nuk citohet në asnjë moment ndonjë pretendim pronësie i ngritur nga ana e ankuesit.

Në këto rrethana, kemi rikërkuar nga ana juaj të na sqarohet se, cilat kanë qënë gjetjet nga verifikimi në terren lidhur me këtë çështje, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të mbajtur në arkivën e organit tuaj publik, apo edhe në arkivën e Bashkisë Fier, lidhur me ekzistencën e një ndërtimi pa leje të ngritur nga shtetasi Dhimitër Konomi. Kemi kërkuar gjithashtu, të na dërgohet një kopje e praktikës administrative të akteve procedurale administrative të nxjerra nga ana juaj për këtë rast, pas verifikimit të kryer në terren, si dhe të akteve zyrtare të disponuara nga burime të tjera zyrtare, lidhur me këtë çështje.

Kjo kërkesë e jona për shpjegime dhe kopje dokumentacioni zyrtar është përsëritur me shkresën tonë nr. K3/L22-17 prot., datë 05.01.2026, për shkak të mungesës së përgjigjes nga ana juaj.

Së fundmi, me shkresën tuaj nr. 185/1 prot., datë 14.01.2026, na është dhënë informacioni se pas verifikimeve të përsëritura të kryera në terren dhe krahasimit me të dhënat në

certifikatën e pronësisë, shtetasi Lefter Troka ka në pronësi, aq sa është përcaktuar në dokumentacionin e tij të pronësisë. Kollonat dhe muri që ky shtetas pretendon të prishë nuk janë në pronësi të tij, por në pronësi të shtetasi Llambi Kozma Ikonomi, i cili posedon certifikatë pronësie për truallin, përkatësisht pasuria nr. 2/358. Sipas kufijve të pronës, të pasqyruar në dokumentacionin përkatës, në përgjigje thuhet se z. Troka, ka certifikatë pronësie për pasurinë me nr. 2/85, me sipërfaqe totale 99.50 m2, nga e cila 81.50 m2 është ndërtesë.

Për sa i përket aksesit në banesë, në përgjigje thuhet se është i kalueshëm, si nga ana përendimore dhe nga ana lindore, ku ka ndërtuar edhe një mur rrethues larg nga themeli i shtëpisë së tij, përafërsisht 120 cm, ku duket qartësisht aksesi në banesë. Kollonat, të cilat pretendohen për tu prishur, janë ndërtuar para 28 vitesh dhe, në përgjigje thuhet se, siç jemi vënë në dijeni me shkresën tuaj të mëparshme, organi juaj publik nuk disponon asnjë dokument që autorizon prishjen e objektit në fjalë. Sipas arkivës ekziston vetëm procesverbali i vitit 1998, për vendosjen e gjobës administrative prej 5,000 (pesë mijë) lek, për shkelje të ligjit për ndërtimet pa leje të asaj kohe.

Ndodhur në këto kushte thuhet se, organi juaj publik nuk mund të procedojë në një rast të tillë, përderisa objekti ka marrë një masë administrative vite më parë dhe prej asaj kohe nuk ka ndërtime, ose shtesa të reja. Për më tepër, thuhet se lidhur me prishjet, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit mund të procedojë në tokë shtetërore, ose ndërtime në pronën e një pretenduesi tjetër.

Bashkëngjitur kësaj përgjigjeje janë dërguar edhe kopja e këtyre dokumentave zyrtarë:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. serial 1058371, për pasurinë nr. 2/358, z.k. 8534, volum 8, faqe 22, e llojit "truall", me sipërfaqe 68.20.m2, ndodhur në rrugën "Apollonia", Fier, në pronësi të shtetasit Llambi Kozma Ikonomi, e lëshuar nga ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, në datë 30.03.2015.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë së sipërcituar, datë 30.03.2015.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, të sipërcituar.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. serial 1795174, për pasurinë nr. 2/85, z.k. 8534, volum 15, faqe 64, e llojit "truall", me sipërfaqe 99.50 m2 dhe ndërtesë 81.50 m2, ndodhur në rrugën "Apollonia", Fier, në pronësi të shtetasit Llambi Kozma Ikonomi, e lëshuar nga ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, në datë 06.12.2018.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë së sipërcituar, datë 06.12.2018.

Nisur nga konstatimet e kryera për këtë çështje del e nevojshme kryerja e një analize të legjislacionit rregullator të fushës për të kuptuar bazueshmërinë e veprimeve të kryera nga ana juaj, si dhe kompetencat ligjore që iu jepen nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e këtij rasti.

Ligji bazë specifik që përcakton fushën e veprimit dhe kompetencat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore është ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",.i ndryshuar *(ligji nr. 9780/2007)*. Në nenin 2, të këtij ligji parashikohet se, objekti i tij është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe i përgjegjësive të tyre.

I përcaktuar si një nga organet e inspektimit ndërtimor, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore, ka si përgjegjësi të tij ligjore,[2] ushtrimin e kontrollit të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe të atyre të parashikuara në ligje të tjera.

E gjithë kjo veprimtari zhvillohet mbi bazën e proceseve verifikuese dhe vendimmarrjes sanksionuese, të parashikuara këto në legjislacionin në fuqi.

Ndër detyrat/kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 9780/2007, për inspektoriatin e mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, në nenin 5, shkronjat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh", parashikohet detyrimi se gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, (të po këtij ligji), ky inspektoriat merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit,
d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm,
dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Këto kompetenca bëhen më të qarta nga përkufizimi i dhënë në paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: *"Fjala "ndërtim/punim", sipas këtij neni përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen në dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit".*

Në vazhdim, në nenin 12, pika 8, gërma "c", të ligjit nr. 9780/2007, parashikohet se:

"Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

*c) **të përfshijnë në kontrollin e tij** prishjen e një ndërtimi ekzistues,* ndërtimin *apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe* punimet/ndërtimet, *që paraqesin rrezik shembjeje,* me pasoja *për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe* mbi pasurinë e të tretëve".

Ndërkohë, në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar, në nenin 3, pikët 20 dhe 21, si dhe në nenit 39, pika 1, parashikohet se:

[2] Neni 4, paragrafi i parë, i ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar.

"20. "Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë",

21. "Ndërtim/punim pa leje", janë ato procese dhe/ose projekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e lejes së shfuqizuar",

"1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji".

Në nenit 51, pikat 1-3, të po këtij ligji, parashikohet se:

"1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësive, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar".

Në një akt tjetër normativ dhe përkatësisht, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit", të ndryshuar, në nenin 1, parashikohet se:

"1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, si dhe garantimi i përdorimit të sistemit elektronik të lejeve nga të gjithë aplikuesit dhe institucionet e përfshira, me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimit me një ndalesë".

Së fundmi, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore" *(VKM nr. 894/2015)*, në nenin 1, gërma "a", parashikohet se kompetencat e dhëna në këtë akt nënligjor për kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, parashikohen në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007.

Në vijim në pikën 1, gërma "b", nëngërmat "ii" dhe "iv", të VKM-së nr. 894/2015, parashikohet se:

"b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

ii) kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qëndrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;

iv) përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi".

Bazuar në kompetencat që gëzoni nga ligji, del e qartë se IMT-ja në Bashkisë Fier, bazuar në njoftimin e vet ankuesit, ka kompetencën e plotë të verifikimit në vend të ndërtimeve, apo punimeve të pretenduara si të kundërligjshme, të kryera në këtë rast nga shtetasi Dhimitër Konomi.

Pohimi i dhënë në shkresën tuaj nr. 4211/1 prot., datë 09.04.2025, se është kryer verifikimi i përsëritur në terren gjatë të cilit nuk janë konstatuar punime, ose ndërtime të reja, ndërkohë që nuk shpreheni lidhur me faktin nëse ndërtimi i kryer nga shtetasi Dhimitër Konomi (edhe pse kjo gjë iu është kërkuar nga ana jonë), është një ndërtim i ligjshëm apo jo, tregon mosveprimin e organit tuaj publik në këtë rast.

Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti se, kopja e dokumentacionit zyrtar të dërguar bashkëngjitur shkresës suaj nr. 4211/1 prot., datë 09.04.2025, nuk legjitimon dhe aq më tepër nuk certifikon ligjshmërinë e ndërtimit të kryer nga shtetasi Dhimitër Konomi. Kjo pasi, jo vetëm që mungon dhe nuk na është dërguar kopja e praktikës dokumentare administrative e verifikimeve tuaja të pretenduara që janë kryer në mënyrë të përsëritur në terren, por nuk ka asnjë dokument zyrtar përkatës provues që mund të jetë paraqitur nga shtetasi Dhimitër Konomi, gjatë inspektimeve të kryera nga ana e inspektorëve të organit tuaj publik, që vërteton ligjshmërinë e ndërtimit të kryer prej tij, në këtë rast objekt ankimi.

A ka kryer verifikime të nevojshme organi juaj publik, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Fier, lidhur me ligjshmërinë e ndërtimit për të cilin është nxjerrë procesverbali nr. 600285, datë 25.08.1998, nga inspektori përkatës i Urbanistikës së Rajonit nr.4, Bashkia Fier? Na rezulton se jo. Ky verifikim do të ishte i nevojshëm në radhë të parë, për të saktësuar dhe përditësuar saktësinë e dokumentacionit kadastral të pronësisë së z. Konomi, por edhe të z. Troka, në kushtet kur kopja e dokumentacionit kadastral të pronësive të tyre përkatëse datón në vitet 2015 dhe 2018. Jo vetëm kjo, por fakti që kemi një akt procedural zyrtar të vitit 1998, të inspektorëve të urbanistikës të Bashkisë Fier, në të cilin konstatohet një ndërtim i kundërligjshëm, do të kërkonte verifikim të mëtejshëm të faktit nëse ky ndërtim (ndoshta i përfunduar tashmë), është vetëdeklaruar për legalizim, apo jo.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, në përmbajtjen e procesverbalit nr. 600285, datë 25.08.1998, në cilësinë e një akti verifikues dhe me natyrë akuzuese në kuadër të kryerjes së një kundërvajtjeje administrive administrative, thuhet se: *"Oytetari Dhimitër Konomi ka ndërtuar një objekt në fazën e plinta kollonave pa leje, ngjitur me objektin e Lefter Troka. I pengon anën funksionale të banesës".*

Në këto rrethana dhe bazuar në informacionin që na keni dhënë për këtë çështje (për sa sqaron ky informacion), tregon qartësisht se ky ndërtim është i kundërligjshëm, pavarësisht kohës së ngritjes së tij. Konstatimi i kryer në vitin 1998, flet për pengesë të anës funksionale të banesës së z. Troka, nga ndërtimi i kryer në këtë rast nga shtetasi Dhimitër Konomi. Megjithatë, edhe ky aspekt i çështjes nuk është analizuar dhe verifikuar nga ana juaj.

Pavarësisht shpjegimeve të dhëna mbetet i pakuptimtë dhe pa bazë ligjore pretendimi i ngritur në përgjigjen tuaj më të fundit drejtuar Avokatit të Popullit, sipas të cilit, organi juaj publik nuk disponon asnjë dokument që autorizon prishjen e objektit në fjalë. Ndërkohë thuhet prej jush se, sipas arkivës ekziston vetëm procesverbali i vitit 1998, për vendosjen e gjobës administrative prej 5,000 (pesë mijë) lek, për shkelje të ligjit për ndërtimet pa leje të asaj kohe. Në këtë kuptim sqarojmë se edhe nëse do të ekzistonte një akt i tillë administrativ për prishjen e objektit të ngritur nga shtetasi Dhimitër Konomi, ai do të rezultonte i paekzekutuar dhe në kushtet e humbjes së fuqisë juridike, për shkak të kalimit të afateve ligjore të ekzekutimit të tij, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi të kohës kur ai është nxjerrë.

Në vijim, konstatojmë se sërish nuk ka bazë ligjore dhe nuk qëndron arsyetimi i dhënë se, organi juaj publik nuk mund të procedojë në një rast të tillë, përderisa objekti ka marrë një masë administrative vite më parë dhe prej asaj kohe nuk ka ndërtime, ose shtesa të reja. Aq më tepër nuk qëndron pretendimi juaj, sipas të cilit, lidhur me prishjet, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit mund të procedojë në tokë shtetërore, ose ndërtime në pronën e një pretenduesi tjetër.

Bazuar në kompetencat që gëzon nga ligji, IMT-ja në Bashkinë Fier, nuk provon të ketë ushtruar, madje dukshëm nuk i ka ushtruar kompetencat ligjore në trajtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje.

Mosveprimi nga ana e IMT-së në Bashkinë Fier, për trajtimin e këtij rasti dhe lejimi i kësaj gjendjeje theksojmë se mund të përbëjë premisa të shkaktimit të një dëmi të vazhduar, ndaj palës ankuese.

Nisur nga qëndrimi i mbajtur për këtë çështje nga ana juaj, jo vetëm që legjislacioni në fuqi i jep inspektorëve të organit tuaj publik mundësinë që të verifikojnë në terren ligjshmërinë e ndërtimit, apo punimeve ndërtimore tashmë të kryera, por kompetenca e tyre ligjore shkon edhe më tej, pasi është ky organ publik që shpesh njoftohet, apo i kërkohet që të prishë ndërtime të kundërligjshme, të cilat janë përfshirë paraprakisht në procesin e legalizimit, por për të cilat vendimmarrja nga organi kompetent publik ka qënë refuzuese, pra për përjashtim nga procesi i legalizimit. Kur sjellim në vëmendje këtë fakt kemi parasysh ndërtime të kundërligjshme, për të cilat është kryer vetëdeklarimi prej shumë vitesh më parë, por për të cilat pas vendimit për përjashtim nga procesi i legalizimit është vendosur prishja e tyre.

Në trajtimin e kësaj çështjeje, del e qartë se ka një mosveprim të vazhduar dhe shmangie në marrjen e përgjegjësisë institucionale, si dhe të ushtrimit të kompetencave që organi juaj publik gëzon në bazë të ligjit nr. 9780/2007.

Është mëse e ligjshme që të kërkosh gëzimin e të gjithë të drejtave që rrjedhin nga pronësia e ligjshme, por është e pafalshme që të bëhesh pjesë e shkeljes së këtyre të drejtave me mosveprimin e pajustifikuar ligjërisht.

Zbatimi i ligjit dhe kompetencave që rrjedhin prej tij nuk duhet lejuar të bëhen çështje dëshire nga punonjësit, të cilëve iu ngarkohet kjo detyrë, pasi rigoroziteti i kërkuar në këtë drejtim bëhet gjithmonë shkak për kërkimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale. Ky mosveprim nuk jep imazhin e kërkuar të një organi publik në shërbim të qytetarëve, por të një organi publik që zvarrit zgjidhjen dhe bëhet shkak i shkeljes së të drejtave të ligjshme të individëve.

Për më tepër, konstatojmë se kjo mënyrë trajtimi e çështjes nuk respekton një nga parimet kryesore të veprimtarisë së administratës publike, të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në një sërë aktesh normative ndërkombëtare, parim ky që lidhet me të drejtën për proçesin e rregullt ligjor dhe atë të marrjes së vendimeve.

Avokati i Popullit nuk inkurajon ngritjen e asnjë ndërtimi të kundërligjshëm, prandaj ndan qëndrimin se kjo kulturë mosreaguese ndaj ndërtimeve pa leje duhet të mbarojë!

Në proçesin e ndërmjetësimit nga ana jonë për zgjidhjen e kësaj çështjeje duam t`iu kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

"Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të".

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre dhe jo të bëhen shkak me mosveprimin e tyre, në vazhdimin e shkeljes dhe mosrespektimit të këtyre të drejtave.

Detyrimi për mbrojtjen e pronës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj, sikurse edhe në këtë çështje, është parashikuar shprehimisht edhe në paragrafin e parë, të nenit 1, të protokollit 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku parashikohet se:

"Çdo person fizik, ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ku parashikohet se:

"Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",*

REKOMANDOJMË

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Fier, brenda 60 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të nxjerrë dhe t'i komunikojë me shkrim shtetasit Lefter Troka, vendimin formal dhe të arsyetuar mbi kërkesën e tij, duke i dërguar Avokatit të Popullit kopje të vendimmarrjes, ku të pasqyrohen:

a) pretendimet e ankuesit;

b) faktet e konstatuara;

c) argumentet ligjore mbi vjetërsinë e objektit, masën administrative të vitit 1998 dhe statusin pronësor të truallit;

d) përfundimin e procedurës me vendimmarrje dhe njoftimin e të drejtave të ankuesit.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ju lutemi të na ktheni përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi, duke njoftuar masat e marra për zbatimin e tij.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

KOMISTONERE

Erinda MELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AVOKATI I POPULLIT ·